

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbime Profesionale për Shëndetin e Sigurinë në Punë, Sistemet e Menaxhimit ISO, Monitorim Mjedisor dhe mbështetje për lejet mjedisore

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71317000-3 dhe 90714200-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

11,724,000 (njembedhjetë milion e shtatëqind e njëzet e katër mijë) Leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pike plotësohet me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 26, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe Ligj nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (c).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në Ligjin nr. 29/ 2023, datë 2.05.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i

ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM Nr. 922, datë 29.12.2014 *PËR DORËZIMIN E DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE* (Ndryshuar me VKM nr. 211, datë 9.4.2025).

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285 e perditesuar, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 e perditesuar datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4. Kërkesa të tjera

1. Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 6 (gjashtë) punonjës, nga këta të paktën 2 konsulentë që të vertetojnë që angazhohen, janë të kualifikuar dhe kanë eksperiencë në hartimin e dokumentacionit, implementimit dhe asistencës për standardet ISO 9001, 14001, 45001, SA 8000 dhe 27701. Kjo e vertetuar nga deshmi përkatës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

1. Operatori Ekonomik të ketë të paktën dy persona të diplomuar për inxhinieri IT/Elektronike/Elektrike dhe me kualifikime apo trajnime të ndryshme mbi standardet ISO dhe Ceshtjet e Sigurisë e Shëndetit në Pune. Kjo e vertetuar nga deshmi përkatës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2. Operatori Ekonomik duhet të ketë dy nga konsulentët e tij që të kenë përvojë si Lead Auditor për auditimin e standartit dhe versionit të fundit të ISO 9001, 14001, 45001. Për të deshmuar këtë pikë konsulenti duhet të paraqesë vertetim/deshmi nga një trupë certifikuese e Akredituar për këto ISO dhe deshmi përkatës si Lead Auditor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

4. Operatori Ekonomik gjithashtu të ketë pjesë të stafit të tyre të brendshëm apo të jashtëm me kontratë një ekspert në fushën e auditimeve dhe konsulencave të mjedisit, ky i fundit të jetë

a. i pajisur me certifikate si Ekspert Mjedisor

b. Vertetim nga nje trupe certifikuese e akredituar per ISO 14001, qe eshte pjese e kesaj trupe si Lead Auditor per ceshtjet mjedisore;

c. Deshmi mbi trajnime dhe kualifikime mbi mjedisin, mbrojten, vleresimi dhe ndikimin ne mjedis, etj. Certifikatat e leshuara si Lead Auditor per SO 14001 te jene te akredituara nga nje organ sipas ISO 17024, kombetare dhe nderkombetare.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

5. Operatori Ekonomik duhet te vertetoje qe dy prej Lead Auditoreve te jene edhe pjese e nje trupe certifikuese te Akredituar sipas ISO 17021 dhe qe kryen auditime certifikimi per trupen per ISO 9001, 14001, 45001, si prove per kualifikimin e tyre duhet te paraqiten vertetime nga trupa certifikuese e akredituar per keto persona.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

6. Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur dhe i certifikuar me sistemin e menaxhimit sipas ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2022. Te katra certifikatat te jene te vlefshme dhe te leshuara nga nje OVK e akredituar per te treja standardet. Akreditimi i OVK duhet te njihet nga DA e Shqiperise ose ent nderkombetar akreditimi i njohur ne Republiken e Shqiperise.

7. Operatori Ekonomik ofertues duhet qe aktivitetin e konsulences dhe certifikimi te standardeve ISO ta kete pjese te objektit te paraqitur ne QKB. Gjithashtu te jete i Licensuar nga QKL sipas licences X.2.B per Trajnime dhe formim profesional per formim profesional te ndryshuar sipas udhezimit te Ministrit Nr.1093 date 12.12.2024 dhe relacionit Nr.975 date 18.04.2025.

Kjo duke e vertetuar me aneksin dhe miratimin nga Agjensia Kombetare e Aftesive dhe Pune. Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i Licensuar I.2 A per Sherbime ekspertize (studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 2, pika 4 germa a dhe b dhe c, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

L I G J Nr. 8766, datë 5 .4.2001 (Ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009 nr. 11/2013, datë 14.2.2013) (I përditësuar) PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN

VKM nr. 538 date 26.05.2009 ANEKSI 1 KATEGORITË E LICENCAVE E LEJEVE QË SI RREGULL TRAJTOHEN NGA OSE NËPËRMJET QKL-SË 2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon: a) “Shërbime ekspertize” me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij dhe Ligjit 14/2024 Për miratimin e strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës Së Shqipërisë.

ARTIKULLI/ ARTICOLO	PERSHKRIMET/SPERCFIKIMET TEKNIKE DESCRIZIONE /SPECIFICHE TECNICHE	NJESI MATESE/ UNITA' DI MISURA	SASIA/ QUANTITA'
Sherbime mujore per shendetin dhe sigurine ne pune	Asistence, konsulence dhe trajnime me frekuenca mujore për të gjitha çështjet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit. Kontrata jone vjetore e asistencës për sigurinë në punë do të përfshijë (sipas nevojës): Vizita periodike në Kompani 8-10 (tete-dhjete) here ne muaj - për të kontrolluar statusin e përditësimit të dokumentacionit të detyrueshëm, - te azhurnojë ose krijojë dokumentacione/procedura/rregulla per faza pune apo funksione te kompanise per vleresimin e riskut ne pune dhe metoda te sigurta pune - të verifikojë edukimin dhe trajnimin e personelit - përcaktimin e informacionit, instruktimin, trajnimin, planifikimin e kurseve në fushën e shëndetit dhe sigurisë. - të bashkëpunojë me mjekun kompetent në përcaktimin e protokollit shëndetësor dhe të zhvillojë trajnime mbi ndihmën e parë - organizimin dhe zhvillimin e testit të evakuimit, simulime emergjencash ne pune; - organizimin dhe zhvillimin e mbledhjes periodike, me hartimin e procesverbalit; - hartimin e procedurave dhe udhëzimeve të sigurisë; - menaxhimin e marrëdhënieve me Përfaqësuesit e Inspektoriatit te Punes; - të menaxhojë marrëdhëniet me organet publike përgjegjëse për kontrollin (Inspektorët e Punës, Zjarrfikësit, etj.) - të ndihmojë klientin në rast të një inspektimi nga organet certifikuese per standardet ISO. - Monitorim te Mbledhjeve te Keshillit te sigurise - Certifikim te personelit mbi sigurine teknike, MNZSH, ndihma e pare e siguria ne pune.	Muaj	36

Auditime certifikuese per sisteme te menaxhimit (Cilesia, Mjedisi, Siguria ne vendin e punes e privacia dhe mbrojtja e te dhenave)	Sherbime te mbikqyrjes vjetore per sisteme te menaxhimit (Cilesia, Mjedisi, Siguria ne vendin e punes dhe Pergjegjesia Sociale) Kohezgjatja 8 dite pune Data e planifikuar e mbikqyres 1 muaj para dates se skadimit vjetor, sic eshte dhene tashme ne certifikatat e meparshme (per cilesine 9001:2015, per mjedisin ISO 14001:2015, SA 8000:2014 dhe sigurine ISO 45001:2018 dhe ISO 27701 referuar ligjit 14/2024 Për miratimin e strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës Së Shqipërisë 	Vit	3												
Sherbim per monitorimin mjedisor, raportime periodike dhe konsulenca per plotesimet e kerkesave te lejes mjedisore / Servizio di monitoraggio ambientale, report periodici e consulenza per l'adempimento dei requisiti dell'autorizzazione ambientale	<u>A. Monitorimi mjedisor</u> Bazuar ne programin e monitorimit te lejes mjedisore nr.4241 date 10.10.2022 operatori ekonomik duhet te kryej monitorimin mjedisor sipas tabelës se mëposhteme: <table border="1" data-bbox="391 982 1157 1892"> <thead> <tr> <th>Tipi I shkarkimit</th><th>Parametrat</th><th>Pikat e monitorimit</th><th>Frekuenca e monitorimit</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Monitorimi I shkarkimeve ne ajer</td><td> - Grimcat - PM10 </td><td>3 Pika</td><td>Cdo 6 muaj</td></tr> <tr> <td>Shkarkime ne kanalizime</td><td> - pH - Temperatura - Oksigjeni i shperbere - N-NH4 - Rrjedhja ditore - Niv max i rrjedhjes ditore - Perberes organike te fosforit - BOD5 - COD - Lenda totale ne suspension </td><td>1 pike</td><td>Cdo 6 muaj</td></tr> </tbody> </table>	Tipi I shkarkimit	Parametrat	Pikat e monitorimit	Frekuenca e monitorimit	Monitorimi I shkarkimeve ne ajer	- Grimcat - PM10	3 Pika	Cdo 6 muaj	Shkarkime ne kanalizime	- pH - Temperatura - Oksigjeni i shperbere - N-NH4 - Rrjedhja ditore - Niv max i rrjedhjes ditore - Perberes organike te fosforit - BOD5 - COD - Lenda totale ne suspension	1 pike	Cdo 6 muaj	Sherbim	36
Tipi I shkarkimit	Parametrat	Pikat e monitorimit	Frekuenca e monitorimit												
Monitorimi I shkarkimeve ne ajer	- Grimcat - PM10	3 Pika	Cdo 6 muaj												
Shkarkime ne kanalizime	- pH - Temperatura - Oksigjeni i shperbere - N-NH4 - Rrjedhja ditore - Niv max i rrjedhjes ditore - Perberes organike te fosforit - BOD5 - COD - Lenda totale ne suspension	1 pike	Cdo 6 muaj												

	- Fosfori total - Azoti Total		
Ujera siperfaqesore	- Rrjedha - pH - Temperatura - Lende pezull - BOD5 - COD - Lenda totale ne suspension	1 pike	Cdo 6 muaj
•	Zhurmat LAeq dB(A) dite	3 Pika	Cdo 6 muaj

B. Raportimet periodike bazuar ne urdherin nr. 126 date 10.06.2022 Per proceduren e dorezimit/pranimit te dokumentave dhe raporteve te vetemonitorimit, per subjektet e pajisura me leje te tipit A ose B.

Dorezime 6 mujore

Kushti i lejes Mjedisore	Zbatimi i kushteve periodike 3 ose 6 mujore
1.6	Vendndodhja e ushtrimit te veprimtarise
6	Njoftimet
7	Shkarkimet
7	Plani i menaxhimit te tretesave organike
7	InspektimeVizualeDitore/Javore/Mujore per instalimet dhe shkarkimet ne ajer, uje, toke, zhurme, mbetje.
7	Mirembajtja/Plani i Sherbimeve

8	Menaxhimi i mbetjeve
8	Plani i Menaxhimit te mbetjeve
9	Zhurmat dhe Vibracionet
11	Monitorimi
12	Dokumentimi dhe Raportimi
12	Raporti Periodik i Monitorimit

Pergjate nje viti kalendarik ka 2 dorezime 6 mujore

Dorezime Vjetore

Kushti I lejes Mjedisore	Emertimi I Dokumentit
2	Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e perberesve te mjedisit per instalimin/impiantin
2.9.2	Programi I menaxhimit te mjedisit
2.9.2	Regjistri I Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes – Raporti per vitin paraardhes
2.9.2	Regjistri I Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes – Propozim per vitin actual
2.9.2	Raport permbledhes mbi rezultatet e monitorimit te zhurmes
2.9.2	Pershkrimi I monitorimit te mjedisit
2.9.2	Pershkrimi I Incidenteve/Aksidenteve
2.9.2	Raport permbledhes per Auditimin e Eficences se Energjise

2.9.2	Raport per vleresimin e eficences se shfrytezimit te lendeve te para dhe reduktimin e gjenerimit te mbetjeve
2.9.2	Menaxhimi I mbetjeve
2.9.2	Raport Permbledhes per Auditimin e Eficences se Ujit
2.9.2	Deklarate mbi masat per parandalimin e ndotjes se mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit
2.9.2	Program I Menaxhimit te Rriskut
2.9.2	Plan I Perputhshmerise
2.9.2	Plani I cmontimit ose rehabilitimit
10	Lendet e para dhe shfrytezimi I energjise
12	Dokumentimi dhe Raportimi
	Raport mbi ankesat
13	Incidentet dhe veprimet gjate emergjencave
14	Cmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas nderprerjes se operacioneve
	Raporti Vjetor I Monitorimit

Pergjate 1 viti kalendarik ka 1 raportim vjetor

C. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe plotesimi i kerkesave te tjera te lejes mjedisore (pervec atyre te permendura ne piken B):

- Paraqitja e detyrave sipas lejes mjedisit
- Analize mjedisore dhe ligjore per aspektet mjedisore (vleresim i perputhshmerise te aktivitetit me lejen mjedisore, kontratat e mbetjeve, nevojave te ndryshimeve dhe permiresimeve te shkarkimeve etj)
- Regjistrat
 - a. Regjistri i mbetjeve
 - b. Regjistri i shkarkimeve (uje, ajer, zhurma, etj)
 - c. Regjisitri i plotesimit te kushteve te lejes mjedisore

	d. Rregjister per incidentet me pasoja ne mjedis e. Rregjister per ankesat me krakter mjedisor <i>Regjistrat kontrollohen 4 here ne vit per plotesimin e tyre.</i> • Procedure per veprime korrigjuese per mos zbatim te kushteve te LM • Procedura per trajnimin e stafit • Procedura e informimit te publikut mbi performancen mjedisore • Vleresim te rriskut per mbajtjen e ujit per mbrojtjen kundra zjarrit • Program per menaxhimin e rriskut kundra zjarrit • Trajnime te stafit a. Trajnim per plotesimin e regjistrave (monitorimeve, mbetjeve etj) b. Trajnim per kushtet dhe kerkesat e lejes mjedisore c. Trajnim per rastet e emergjences mjedisore, veprimet qe ndermerren (sipas planit te menaxhimit te mjedisit) <i>Trajnimet kryhen ne fillim te konsulences dhe mbikqyren per efektivitetin e tyre.</i> • Asistence teknike sa here ka kontrole te inspektoriatit mjedisor dhe IKMT ne subjekt. • Konsulence per menaxhimin e mbetjeve te aktivitetit, identifikim te kodeve dhe menaxhim sipas kerkesave ligjore. • Asistence teknike per te qene konform legjislacionit mjedisor ne fuqi. • Perditesim me ndryshimet e legjislacionit dhe kerkesat e reja te lejes mjedisore. • Asistence teknike ne raste ndotje aksidentale • Konsulence per perputhshmeri me te mire me standarte nderkombetare, marreveshje dhe konventa mjedisore. • Konsulence per perpuethshmerine e lejes mjedisore me aktivitetin dhe identifikim te nevojave per ndryshim te lejes mjedisore duke percaktuar proceduren respective. • Konsulence ne perpilim shkresash, ankime dhe advokaci teknike mjedisore ne raste te vendimeve arbitrare te organeve mjedisore. .		
--	---	--	--

	Pergatitje shkresash dhe komunikimi me institucionet përgjegjëse mjedisore AKM, ARM, IKMT, Ministrinë e Mjedisit		
--	--	--	--

Argumentim i Specifikimeve Teknike

Objekti: Shërbime profesionale për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, Sistemet e Menaxhimit ISO dhe Monitorimin Mjedisor.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë:

Shërbime për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë

Asistencë dhe konsulencë periodike për zbatimin e legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përditësimin dhe hartimin e dokumentacionit të detyrueshëm, vlerësimeve të riskut dhe procedurave të punës.

Organizimin e trajnimeve të stafit, simulimeve të emergjencës dhe testeve të evakuimit.

Mbështetje gjatë inspektimeve nga autoritetet kompetente dhe koordinim me mjekun e punës.

Certifikimin dhe trajnimin e punonjësve për sigurinë teknike, mbrojtjen nga zjarri dhe ndihmën e parë.

Mbikëqyrja e Sistemeve të Menaxhimit

Kryerjen e auditimeve të mbikëqyrjes për sistemet e menaxhimit:

ISO 9001 – Menaxhimi i Cilësisë;

ISO 14001 – Menaxhimi Mjedisor;

ISO 45001 – Shëndeti dhe Siguria në Punë;

SA 8000 – Përgjegjësia Sociale;

ISO 27701 – Menaxhimi i Privatësisë së të Dhënave.

Mbështetje për ruajtjen dhe rinovimin e certifikimeve.

Monitorimi Mjedisor dhe Leja Mjedisore

Kryerjen e monitorimeve mjedisore sipas kërkesave të lejes mjedisore (ajër, ujëra, zhurma dhe shkarkime).

Përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve periodike dhe vjetore pranë institucioneve përgjegjëse.

Mbajtjen dhe përditësimin e regjistrave mjedisorë dhe dokumentacionit të kërkuar.

Ofrimin e asistencës teknike gjatë kontrolleve nga autoritetet mjedisore dhe këshillimin për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi.